



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 711 Dt. 15.12.2022
PRISHTINË • PRISHTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Vendimet e Bordit të FBK-së të datës 15.12.2022, Prishtinë

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 15.12.2022 në Prishtinë e ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin kosovar të krijuar së fundi në ndeshjen finale të Superkupës së Kosovës në mes KB Sigal Prishtina dhe KB Trepca, dhe ka vendosur që masat që kërkohet të zbatohen me përpikëri nga organet e FBK në vijim të garave janë:

1. Të kufizohet numri i ulëseve në terren, në varësi të konfigurimit të palestrës, për të garantuar moscenimin e terrenit nga publiku i pranishëm;
2. Të mos lejohet pengimi i pjesëmarrësve të ndeshjes nga publiku i pranishëm përreth terrenit të lojës;
3. Të shtohen masat e sigurisë dhe kontrollet për publikun, duke ndaluar futjen e çfarëdo mjeti që mund të rrezikojë sigurinë e pjesëmarrësve dhe shikuesve;
4. Të emërohet një komesar i sigurisë për çdo ndeshje, i cili do të garantojë mbarëvajtjen e ndeshjeve dhe organizimit;
5. Para secilës ndeshje, organizatori të paraqesë planin e sigurisë me shkrim tek Komisarit të Garave, i cili të njëjtin ia përcjell tutje delegatit të ndeshjes, gjyqtarit kryesor dhe komesarit të sigurisë;
6. Të zbatohen me përpikëri Propozicionet e Garave dhe Rregullorja e Garave të FBK, duke garantuar, mes tjerash:
 - 6.1 Zbatimin e dispozitave që rregullojnë ndalesën e sharjeve në kor;
 - 6.2 Zbatimin e dispozitave që rregullojnë hudhjet në terren, përfshirë edhe hudhjen e mjeteve të cilat nuk rrezikojnë jetën apo shëndetin e pjesëmarrësve;
 - 6.3 Zbatimin e dispozitave që rregullojnë intonimin e himnit shtetëror;
 - 6.4 Zbatimin e dispozitave që rregullojnë garantimin e sigurisë në terren, përfshirë rastet e mospërputhjes së veprimit të organizatorit në pajtim me ligjet e zbatueshme dhe planin e sigurisë;
7. FBK dhe klubet të organizojnë fushatë të përbashkët vetëdijesuese për pasojat e veprimit në kundërshtim me propozicionet e garave.
8. FBK dhe klubet të organizojnë xhirimin e keqsjelljes së personave të pranishëm në terren dhe të koordinohet ndarja e imazheve me organet e ndjekjes dhe zbatimit të ligjit.
9. Të vazhdojë ndalesa e udhëtimit të tifozerive mysafire për të gjitha aktivitetet sportive të organizuara nën ombrellën e FBK-së.
10. Organizimi i Kupës së Kosovës të bëhet pa spektatorë.
11. Ndalohet rreptësisht shitja dhe konsumi i pijeve alkoolike konform Ligjit për Parandalimin dhe Sankisonimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Gjithashtu Bordi i FBK-së zotohet se do ti zbatojë në përpikëri rekomandimet e Këshillit për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive:

1. Të ndalohet pjesëmarrja në mënyrë të organizuar dhe me çfarëdo shenje dalluese e të gjitha grupeve të tifozëve në ndeshjet e basketbollit, të cilat organizohen nga Federata e Basketbollit të Kosovës, deri në një njoftim tjetër;
2. Kërkohej nga të gjitha grupet e tifozëve të cilët deri më tani nuk janë regjistruar tek Departamenti i Organizatave Joqeveritare (DOJQ) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ta bëjnë këtë gjë në afatin më të shkurtër kohor, dhe pas regjistrimit ta deponojnë listën me emrat e kryesisë dhe emrat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të OJQ-së tek Drejtoria për Sport e Komunës përkatëse;
3. Kërkohej nga Federata e Basketbollit të Kosovës që të aplikojë me rigorozitetin maksimal të gjitha dispozitat normative përkatëse që janë në kuadër të Propozicioneve të Garave të FBK-së.
4. Kërkohej nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që ta përfshijë në planifikimin buxhetor për vitin 2023 vendosjen e sistemit të kamerave të sigurisë në të gjitha palestrat sportive, ndërsa në vazhdim të procesit vendosja e kamerave të sigurisë të bëhet edhe në të gjitha stadiumet e futbollit.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU
Kryetar

Federata e Basketbollit e Kosovës



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

